




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SEMAN

VENDIM

Nr.7, datë 28.05.2026



PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE DHE PROCES
TEKNOLOGJIKE, TË SUBJEKTIT "SHELL UPSTREAM ALBANIA
BV", ME VENDNDODHJE: MBRESHTAN, BERAT.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe procese teknologjike, të subjektit "Shell Upstream Albania BV" me vendndodhje: Mbreshtan, Berat.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Rezervuari Mbreshtan.

Vendndodhja e burimit ujor (**Rezervuar**):

- X= 490038.25
- Y= 4508620.25
- Z= 288.34 m

Koordinatat e pikave të shfrytëzimit të burimit ujor (KRGJSH):



X 489800.87

$$Y = 4507811.18$$
$$Z = 372.7 \quad (\text{Shpirag 3})$$

X 489378.84

$$Y = 4510737.01$$

Z= 219.54 (Shpirag 4)

X 489373.81

$$Y = 4510752.22$$

Z= 219.10 (Shpirag 2)

X 488159.78

$$Y = 4512060.92$$

Z= 129.91 (Shpirag 5)

Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 35.7 \text{ l/sek}$

Qëllimi i përdorimit të ujit: Proces teknologjik.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SEMAN

ANDUEL XHINDI

